

RELACION TEKNIK PER NDRYSHIMET NE PROJEKT

Rehabilitimi I aksit "Mbikalim – Kombinat"

Nr. exf Prot

Tiranë, më 10/09/2018

Drejtuar: Investitorit Bashkisë Tiranë

Adresa: Shëtitorja "Dëshmorët e Kombit", Nr.1; 1001; Tiranë

Lënda: Relacion teknik mbi ndryshimet dhe problematikat e hasura gjatë punimeve në objektin
Rehabilitim I aksit "Mbikalim – Kombinat"

PËRMBAJTJA:

- i. HYRJE
- ii. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT EKZISTUES
 - 1. Punime per trafikndaresen
 - 2. Punime per korsite e bicikletave
 - 3. Punime per trotuarin ekzistues
 - 4. Punime per trotuarin e ri
 - 5. Punime per zgjerimin e rruges
 - 6. Punime asfaltimi
 - 7. Punime per prishje per muret rrethuese dhe mbajtese
 - 8. Punime për mure te rinj rrethues Ltot = 770 ml
 - 9. Punime për muret mbajtes
- iii. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË RISHIKUAR
 - 1. Punime per trafikndaresn
 - 2. Punime per korsite e bicikletave
 - 3. Punime per trotuarin e ri
 - 4. Punime per mure mbajtes dhe rrethues
 - 5. Punime për zgjerimin e rruges
 - 6. Punime për ndricimin e rruges

RELACION TEKNIK PER NDRYSHIMET NE PROJEKT

Rehabilitimi I aksit "Mbikalim – Kombinat"

i. HYRJA

Ky relacion jep një përshkrim dhe informacion të përgjithshëm të objektit, problemeve që janë konstatuar në objekt gjatë punimeve dhe ndryshimet në projekt dhe preventiv të objektit : Rehabilitim I aksit "Mbikalim – Kombinat"

Relacioni përshkruan me detaje sesi ka qënë i parashikuar projekti për tu bërë dhe sesi është realizuar, me ndryshimet që janë bërë si kërkesë e terrenit dhe në bazë të kërkesave të investitorit, duke arritur kështu një zgjidhje sa më të mirë teknike dhe funksionale të objektit, duke ju përmbajtur qëllimit kryesor të këtij projekti: cilësinë, sipas standarteve bashkëkohore të shërbimeve publike në të gjithë territorin, dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore.

ii. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT EKZISTUES

Nisur nga relacioni teknik dhe specifikimet teknike të projektit, nderhyrjet ne kete segment te rruges fillojne nga Ura Teknologjike deri në Kombinat me një gjatësi prej **2,310 ml**.

Nderhyrjet ne objekt do te behen përgjithësisht në rikonstruksionin e rrugës ekzistuese dhe ne trotuare. Karexhatat ne dy anet jane me trotuar ekzistues per kalimin e kembesoreve. Per realizimin e projektit eshte menduar qe projekti te ndahet ne tre segmente :

1. Ura teknologjike – Rruga 3 Deshmoret
2. Rruga 3 Deshmoret – Rruga Thoma Koxhaj
3. Rruga Thoma Koxhaj – Kombinat

1. Ura Teknologjike – Rruga 3 Deshmoret



Ne kete segment te rruges korsia e bicikletave do te kaloje ne dy anet e rruges ne trotuar dhe objektet qe preken nga korsia e bicikletave do te prishen. Ne anen e djathate te rruges pas korsise se bicikletes eshte parashikuar prishje muresh dhe riberje si dhe shtohet trotuar I ri 2m.

Ne anen e majte tek kthesa e rruges Sabaudin Gabrani do te kete prishje te trotuarit si dhe pergjate ketij segmenti do te kete trafik ndares 1m.

RELACION TEKNIK PER NDRYSHIMET NE PROJEKT

Rehabilitimi I aksit "Mbikalim – Kombinat"

PRERJA 1-1
rr. e kavajes segmenti
(ura teknologjike-rr.pirro goda)




Rehabilitimi I aksit “Mbikalim – Kombinat”

DETALJ I MURIT RRETHUES
sh 1:20


KOLLONE B/A
20x18
SHUFER METALIKE (d=10x10)mm

Dimensions: 222, 159, 280, 20, 63, 8, 10, 2, 5, 5, 99, 15



RELACION TEKNIK PER NDRYSHIMET NE PROJEKT

Rehabilitimi I aksit "Mbikalim – Kombinat"



RELACION TEKNIK PER NDRYSHIMET NE PROJEKT


Rehabilitimi I aksit "Mbikalim – Kombinat"

2. Rruga 3 Deshmoret – Rruga Thoma Koxhaj

Ne kete segment te rruges korsia e bicikletave do te kaloje ne anen e djathte te rruges ne trotuar. Ne anen e djathte te rruges pas korsise se bicikletes eshte parashikuar prishje muresh dhe riberje si dhe shtohet trotuar i ri 2.5 m. Pergjate ketij segmenti do te kete trafik ndares 1 m.


Muri rrethues qe do te perdoret ne pjeset e nderhyrjes do te jete me kangjella si ne rastin e sipërpermendur me lart ne segmentin e pare.

PRERJA 3-3
rr. e kavajes
seg. (rr.3 deshmoret-rr.thanas koxhaj)



RELACION TEKNIK PER NDRYSHIMET NE PROJEKT


Rehabilitimi I aksit "Mbikalim – Kombinat"



3. Rruga Thoma Koxhaj – Kombinat


Ne kete segment te rruges korsia e bicikletave do te kaloje ne te dyja anet e rruges ne trotuar. Do te kete lulishte qe preken nga korsia e bicikletes e cila do te spostohet si dhe shtohet trotuar I ri 2.5m. tek gjelberimet eshte perdorur dhe nje mur mbajtes, ndersa trafik ndarese nuk do te kete.

PRERJA 4-4
rr. e kavajes
seg. (rr.thoma koxhaj-zjarrfiksat)



RELACION TEKNIK PER NDRYSHIMET NE PROJEKT

Rehabilitimi I aksit "Mbikalim – Kombinat"



iii) PERSHKRIMI I PROJEKTIT TE RISHIKUAR PER PUNIMET SHITESE

Duke qene se ky objekt eshte nje nder rrugët hyrese ne qytetin e Tiranes kerkon edhe nje projekt sa me cilesor dhe dinjitoz.

Nga arzhonimi i objektit dhe krahasimi i tij me projekt preventivin e parashikuar,u vune re mangësi në projekt preventivin e objektit sa më poshtë:

1. Ndertimi i rruges sipas projektit ekzistues nuk lidhet me rrugen e sapo përfunduar nga kompania "Geci" sh.p.k te kthesa e Varrezave Sharrë. Nga perfundimi i projektit e deri ne bashkimin e rruges te kthesa e Varrezave Sharre eshte 240 m linear,ne te cilen duhet te parashikohen si punimet e shtresave te rruges ashtu edhe trotuaret ne te dyja anet.

Ne baze te shkreses Nr.6927/1 date 08.08.2018 te Autoritetit Rrugor Shqiptar si dhe shkreses Nr.30553/1 date 22.08.2018 te Baskise Tirane ,drejtuar shoqerise sone ,kerkohej perfshirja e punimeve rrugore te segmentit prej 240 ml,te pa perfshire ne projektin ekzistues.Mbi bazen e ketyre kerkesave u be llogaritja e volumeve te punimeve per segmentin rrugor prej 240 ml nga te cilat rezultuan punimet shitese per objektin : "Rehabilitimi i aksit Mbikalim-Kombinat".

2. Projekti parashikon shtresave asfaltike, Binder 6 cm dhe Tapet 5 cm dhe parashikon germimin e shtreses ekzistuese t=11-21 cm,

RELACION TEKNIK PER NDRYSHIMET NE PROJEKT

Rehabilitimi I aksit "Mbikalim – Kombinat"

3. Per segmentin rrugor prej 240 ml ne te dy anet e tij kerkohet prishja e trotuareve te vjetra te amortizuara dhe ndertimi i trotuareve te reja se bashku me shtresat perkatese ,shtrese betoni,shtrese rere,f.v.pllaka betoni.
4. Nga azhornimi i objektit u vu re se siperfaqja e asfaltit te ri eshte rritur ne km 0+325 – 0+525 majtas dhe djathtas ne km 0+325 – 0+525 , zgjerimi u be per efekt qe te ruhen korsite 9 – 7 m qe sherbejne per hyrje daljet e kryqezimeve. Zgjerimi nga asfalti ekzistues u be 1m.
- Po keshtu edhe ne km 0+950 – 1+200 majtas + djathtas zgjerimi I rruges u be me 1 m duke zbritur kunetat dhe zevendesuar me asfalt dhe bordura zhvendoset afer pemeve me gjeresi 1 m total nga asfalti ekzistues.
- Po keshtu ne km 1+325 – 1+425 majtas + djathtas djathtas zgjerimi I rruges u be me 1 m duke zbritur kunetat dhe zevendesuar me asfalt dhe bordura zhvendoset afer pemeve me gjeresi 1 m total nga asfalti ekzistues.
- Ne te gjitha kryqezimet rrezja e ktheses eshte ndertuar nga 7-8 m ekzituese ne 15-18m e ndryshuar.
- Ndryshimi i gjatesise se rruges projekti nuk ka parashikuar lidhjen e segmentit me rrugen e varrezave qe eshte ne gjatesi 240 m.

Duke u bazuar ne pikat e trajtuara me siper nga rillogaritjet e volumeve te projekt - preventivit te objektit duke propozuar qe trotuaret te ndertohen te reja „rruga te lidhet me rrugen e rikonstruktuar me gjatesi 240 ml ,volumet sipas struktures se preventivit ndryshojne sipas preventivit.

Si rezultat i punimeve të përshkruara më sipër, të punimeve që shtohen, por edhe të disa punimeve që hiqen, kemi një rritje të vlerës së preventivit fitues e cila tejkalon vlerën e fondit rezervë (5%) të parashikuar. Të gjitha punimet shtesë, të paparashikuara vijnë si pasojë e azhornimit të projektit me faktin, punimeve të paparashikuara dhe punimeve shtesë për shkak të ndryshimeve.

Këto punime shtesë janë të domosdoshme për të realizuar rehabilitimin e aksit “Mbikalimi – Kombinat”, sipas standarteve dhe kushteve teknike, për ti bërë ato sa më funksionale për komunitetin.

Ndryshimet e përshkruara në mënyrë të përgjithshme më sipër, paraqiten në mënyrë të detajuar, në sasi dhe vlera në preventivin shtese, preventivin total dhe tabelen e volumeve te objektit.

Bashkangjitur gjeni shkresat e Autoritetit Rrugor dhe Bashkise Tirane.

Sipërmarrësi i Punimeve

“G.P.G Company ” sh.p.k

Drejtues Teknik

Administrator

Ing. Gezim DANI

Ing. Paqzor BUZI

